

**UDHËZIM**  
**Nr.620, datë 29.12.2005**

**PËR STRUKTURËN VARIETORE TË FIDANËVE DHE MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT VEGJETATIV TË HARDHISË, QË PRODHOHEN NË VEND DHE IMPORTOHEN**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 6, 7 e 20 të ligjit nr.8443, datë 21.1.1999 “Për vreshtarinë, verën dhe produktet e tjera që rrjedhin nga rrushi”, pikës 28.4 të nenit 28, të nenit 29 dhe të nenit 53 të rregullores së miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.505, datë 21.9.2000 “Për miratimin e rregullores për vreshtarinë, verën dhe produktet e tjera që rrjedhin nga rrushi”, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

**UDHËZON:**

1. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë strukturën varietore të fidanëve dhe materialeve të shumëzimit vegjetativ (copa e kalema) të hardhisë që prodhohen në vend dhe/ose importohen, si dhe rregullat e përmirësimit dhe miratimit të saj në të ardhmen.

2. Në zbatimin e këtij udhëzimi, termi i përdorur “Strukturë varietore” ka kuptimin e listës së varieteteve (kultivarëve) të vendit dhe internacionale që deri tani janë vlerësuar dhe menduar si më të përshtatshmit për kushtet klimatiko-tokësore dhe destinacionin e prodhimit.

3. Struktura varietore e fidanëve dhe materialeve të shumëzimit të hardhisë që prodhohen në vend dhe që importohen do të jetë në përputhje me strukturën varietore të vreshtave për prodhim vere dhe për prodhim rrushi për tavolinë, e cila është përcaktuar në dokumentin e strategjisë së zhvillimit të vreshtarisë dhe verës si më poshtë:

- a) Vreshta për prodhim rrushi, me destinacion. rrush tavoline dhe për tharje 20%
- b) Vreshta për prodhim rrushi, me destinacion për prodhim vere 80%
  - për verë të kuqe 80%
  - për verë të bardhë 20%.

4. Lista e varieteteve të fidanëve dhe kalemave që lejohet të prodhohet në vend dhe/ose të importohen do të jetë sipas pasqyrës së mëposhtme:

Nr.	Varietete për rrush tryeze	Varietete për verë të kuqe	Varietete për verë të kuqe
1	Black Magic	Kallmet	Shesh i Bardhë
2	Cardinal	Debinë e Zezë	Debinë e Bardhë
3	Diamante	Serin i Zi	Pulëz
4	Victoria	Vlosh	Moskat kanelle
5	Afuzali	Shesh i Zi	Cerruja
6	Italia	Vranac	Chardoneau (Shardoné)
7	Sulltaninë e Bardhë	Gemza	Riesling gjerman
8	Perlone	Merló	Aligoté
9	Moscat Hmburgu	Pinot Nuar	Pinot Gri
10	Sublima	Cabernet Sauvignon	Trebiano
11	Michele Paglieri	Montepulciano	Tokai
12	Red Glob	Tempranillo	Malvasia
13	Tajka e kuqe	Primitivo	-
14	-	Syrah	-
15	-	Sangiovese	-
16	-	Barbera	-
17	-	Mavrud	-

5. Lista e varieteteve për nënshartesat e fidanëve dhe e copave që lejohen të prodhohen në vend dhe/ose të importohen, do të jetë sipas pasqyrës së mëposhtme:

<b>Nr.</b>	<b>Varietete për nënshartesa</b>
1	Paulsen 1103
2	Rugeri 140
3	SO 4
4	Richter 110
5	420 A
6	Paulsen 779
7	Kober 5 bb

a) Nënshartesa “Kober 5 bb” pranohet në këtë strukturë deri në fund të vitit 2010, mbasi ka gjendje të mbjellë. Rekomandojmë të mos shtohet sipërfaqja e vreshtave “mëmë” me Kober 5 bb, pasi varietetet e tjera të shkruara në listë kanë rezultuar me tregues më të mirë.

6. Lista e varieteteve e përshkruar më sipër, në pikën 4 dhe 5 të këtij udhëzimi, pasqyrohet në katalogun zyrtar të specieve dhe varieteteve bimore, duke bërë ndryshimet e nevojshme sipas rregullave të vendosura.

7. Procedurat që do të ndiqen në të ardhmen, për miratimin e përmirësimeve të mundshme të strukturës varietore, do të jenë:

- a) studimi për germoplazmën e vendit dhe përmirësimi klonal i saj;
- b) studimi për rajonet dhe mikrorajonet potenciale të zhvillimit të vreshtarisë;
- c) demonstrimi dhe studimi në provat krahasuese varietore në 3 fusha eksperimentale (sipas zonave të vreshtarisë), që do të ngrihen me fondet e mbështetjes së bujqësisë brenda 3-mujorit të parë 2008.

ç) rekomandimet e bëra nga studimet dhe rezultatet e demonstrimit dhe provave krahasuese diskutohen nga Këshilli Rregullator i Emërimit të Origjinës.

Vendimet e Këshillit Rregullator të Emërimit të Origjinës do të shërbejnë për miratimin e përmirësimeve në strukturën varietore, sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore.

8. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtorja e Politikave të Prodhimit, Drejtorja e Shërbimit Këshillimor, Shkencës dhe Informacionit Bujqësor në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, Inspektorati i Kontrollit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë.

9. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE  
MBROJTJES SË KONSUMATORIT  
Jemin Gjana**